UDHËZIM
Nr.343, datë 4.10.2010

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.160, DATË 25.1.2007 "PËR PROCEDURAT E NDALIMIT, SEKUESTRIMIT DHE KONFISKIMIT TË MJETEVE PËR KUNDËRVAJTJE ADMINISTRATIVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të neneve 201, 203, 206, 209, 210 e 211 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", nenit 7 të ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 "Për kundërvajtjet administrative" të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.153, datë 7.4.2000 "Për miratimin e Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr.160, datë 25.1.2007, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fund të pikës 8 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Për rastet kur automjetet ndodhen prej më shumë se 12 muajsh pranë pikave të bllokimit të caktuara nga strukturat e Policisë Rrugore, dhe ende nuk janë dërguar në Rezervat e Shtetit, Komisioni i Vlerësimit të Mjeteve rishqyrton kategorizimin e mjetit dhe merr vendimin përkatës.".

b) Në pikën 5 fjalët "…me urdhër të Kryeministrit" zëvendësohen me fjalët "…sipas miratimit të organit që ka këtë kompetencë.".

2. Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit, në bashkëpunim me strukturat e rezervave materiale të shtetit, ndërmarrin të gjitha masat për:

a) rivlerësimin e kategorizimit të mjeteve sipas pikës 1 shkronja "a" të këtij udhëzimi;

b) transferimin e dokumentacionit dhe të mjeteve pranë drejtorive rajonale të rezervave materiale të shtetit;

c) transferimin e dokumentacionit pranë rezervave materiale të shtetit, kur në raste të caktuara drejtoria rajonale e rezervave materiale të shtetit jep paraprakisht pëlqimin për zhvillimin e procedurave të ankandit publik pa u transferuar mjetet nga vendndodhja e tyre aktuale.

3. Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, si dhe strukturat në varësi të tyre.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e tij edhe për mjetet e sekuestruara apo të konfiskuara deri në hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

MINISTRI I BRENDSHËM
Lulzim Basha